



FTESË

NË SESION INFORMUES PËR STUDENTË NGA DREJTIMET E BUJQËSISË DHE TEKNOLOGJISË USHQIMORE

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë” projekt dyvjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti do të përfshijë komunat: **Mitrovicë e Jugut** dhe **Shtime**, të cilat janë bashkë-aplikuese dhe partnere të projektit.

Marrë parasysh kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19 dhe rregullave të publikuara nga IKSHPK për parandalim të përhapjes së virusit, **IADK do të organizojë sesion informues përmes platformës digjitale “ZOOM”, me datë 29.12.2020 nga ora 10.00**, ku ndjekësit do të kenë mundësinë të marrin informata për programin e praktikës me pagesë për studentë nga komunat e lartpërmendura.

Gjatë sesionit informues, të interesuarit do të njoftohen për mundësitë që ofron projekti rreth trajnimeve me të cilat do të përkrahen studentët përfitues, kohëzgjatjen e praktikës, dhe vendet ku mund të angazhohen studentët gjatë kohës së praktikës.

Për qasje në sesion informues ju mund të klikoni mbi këtë link, [https://us02web.zoom.us/j/823 4348 9766](https://us02web.zoom.us/j/82343489766) apo mund të kyqeni edhe përmes numri identifikues të sesionit: **823 4348 9766**.

Për informata më të hollësishme në lidhje me projektin dhe qasjes në sesion informues mund të na kontaktoni edhe përmes adresës elektronike: argjend.gjinovci@iadc.org, iadc@info.org, apo përmes numrave të telefonit: **044 240 106** dhe **049 973 204**.

Sinqerisht,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Zbatuar nga:



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INI CIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA